



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 115

31 gusht

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MBUMK nr. 8, datë 31.7.2012	Për miratimin e rregullave të zbatimit të procedurave të ankandit publik për shitjen e objekteve të projektit 2KR të marra nga përdoruesit, nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR).....	6635
Udhëzim i MPCSSHB nr. 6, datë 1.8.2012	Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 26.1.2012 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurave të shërbimit të kujdestarisë”.....	6639

UDHËZIM
Nr. 8, datë 31.7.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ZBATIMIT TË PROCEDURAVE TË ANKANDIT PUBLIK PËR SHITJEN E OBJEKTEVE TË PROJEKTIT 2KR TË MARRA NGA PËRDORUESIT, NGA AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL (AZHBR)

Mbështetur në nenin 102 pika 4 e Kushtetutës, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik” dhe në mbështetje të pikës 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 27.3.2008 “Për kriteret e vlerësimit dhe të shitjes së traktorëve, makinerive e pajisjeve, të marra nga përdoruesit, si dhe të makinerive, pajisjeve e pjesëve të këmbimit, në gjendje në magazinën e projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, të ardhura grant nga Japonia”,

UDHËZOJ:

1 . DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e hapave dhe procedurave teknike për t’u ndjekur në rastin e ankandit për shitjen e traktorëve, makinerive, serrave me ngrohje, linjave të përpunimit, pjesëve të këmbimit, si dhe pajisjeve të tjera të cilat janë përfituar nga përdoruesit me anë të granteve japoneze, sipas projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” dhe i janë rimarrë atyre për shkak të cilësisë si debitore (më tej “objekti i ankandit”).

2. Kjo rregullore zbatohet në përputhje me kriteret e vlerësimit, të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ankandin, si dhe nga aktet e veçanta që rregullojnë objektet e përmendura në pikën 1 më lart.

3. Procedura e shitjes me ankand është e hapur dhe garanton të drejtën e konkurrencës së lirë e të barabartë ndërmjet ofertuesve, duke mos lejuar diskriminimin e tyre, si dhe administrimin e mirë dhe rigoroz të objekteve të vëna në dispozicion.

2. AUTORITETI PËRGJEGJËS

1. Autoriteti përgjegjës për përgatitjen dhe zhvillimin e ankandit është Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural “AZHBR” në cilësinë e autoritetit shitës.

2. AZHBR-ja organizon dhe drejton ankandin, si dhe lidh kontratat e shitjes me përfituesit.

3. PËRGATITJA E ANKANDIT

1. AZHBR-ja përcakton listën e objekteve të ankandit që do të dalin për shitje, harton dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e ankandit, kërkesat për kualifikim dhe dokumentacionin për pjesëmarrësit.

2. AZHBR-ja ngre brenda strukturës së saj njësinë e ankandit, e cila do të jetë një njësi e përhershme dhe që do të ketë për detyrë administrimin e procedurave të ankandeve, të cilat do të organizohen nga AZHBR-ja përfshirë njoftimet dhe publikimet fillestare deri në fazën e lidhjes së kontratës së shitjes.

3. Për përcaktimin e vlerës fillestare të ankandit në lidhje me objektin e ankandit ngrihet komisioni i vlerësimit.

4. Drejtori i AZHBR-së i propozon Ministrin të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit miratimin e komisionit të vlerësimit, si dhe të përbërjes së tij.

5. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të institucioneve publike ose private, nga ku:

- 1 (një) anëtar i profesionit inxhinier mekanik;
- 1 (një) anëtar i profesionit ekonomist;
- 1 (një) specialist bujqësie.



6. Në rastin e pjesëmarrjes së specialistëve nga sektori privat, me to do të lidhet kontrata e shërbimit, e mbështetur në dispozitat e Kodit Civil.

7. AZHBR-ja vë në dispozicion të komisionit të vlerësimit, listën e objekteve të ankandit që do të vlerësohen dhe shiten, si dhe të gjithë informacionin e kërkuar prej tij.

8. Komisioni i vlerësimit për llogaritjen e vlerës së fillimit të shitjes me ankand mbështetet në vlerën fillestare të kontabilitetit, orët e punës dhe gjendjen aktuale teknike në momentin e vlerësimit, për çdo objekt të ankandit.

9. Në përcaktimin e çmimit të fillimit të ankandit, komisioni bazohet edhe në ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, në çmimet e tregut, të dhënat e INSTAT-it apo të organeve të tjera shtetërore. Komisioni ka përgjegjësi për përcaktimin e saktë të çmimit të fillimit të ankandit për çdo objekt të ankandit.

10. Komisioni i vlerësimit i propozon për miratim Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit vlerën e fillimit të shitjes me ankand të objekteve të ankandit duke llogaritur, sipas rastit, uljet e çmimit, të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për këto objekte.

4. KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË ANKANDIT

1. Për zhvillimin e ankandit krijohet pranë AZHBR-së, komisioni i zhvillimit të ankandit.

2. Drejtori i AZHBR-së i propozon Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ngritjen e komisionit të zhvillimit të ankandit, të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, si dhe përcaktimin e kryetarit të komisionit. Në përbërje të komisionit një anëtar duhet të jetë jurist.

3. Komisioni ka në përbërjen e tij:

- tre përfaqësues nga AZHBR-ja;

- dy përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

4. Komisioni miratohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Vendimet e komisionit merren me shumicë të thjeshtë votash.

5. Komisioni i zhvillimit të ankandit ka për detyrë:

a) të evidentojë të gjithë ofertuesit pjesëmarrës në ankand;

b) të deklarojë çmimin e fillimit të ankandit për çdo objekt të ankandit, duke marrë parasysh vlerësimet e bëra nga komisioni i vlerësimit;

c) të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur nga pjesëmarrësit;

ç) të sigurojë që dhënia e ofertave të vazhdojë derisa të ketë oferta të tjera brenda afateve të përcaktuara, si dhe përpara hapjes së tyre;

d) të deklarojë që fituesi i ankandit të shpallet pjesëmarrësi që ofron çmimin më të lartë;

e) në përfundim të dhënies së ofertave, të shpallë fituesin, mbi bazën e ofertës më të lartë.

6. Komisioni mban procesverbalin e ankandit, në të cilin duhet të jenë të pasqyruara: përbërja e komisionit, pjesëmarrësit, dokumentacioni i paraqitur, kërkesat e tyre, si dhe çmimet e ofruara. Procesverbalin e ankandit është i detyrueshëm për t'u firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit.

5. ZHVILLIMI I ANKANDIT

1. Drejtori i AZHBR-së nxjerr urdhrin për zhvillimin e ankandit, në të cilin përcaktohen: dokumentacioni i kërkuar për pjesëmarrjen në ankand, data, vendi dhe ora e zhvillimit të ankandit, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, si dhe ftohen të interesuarit të paraqesin ofertat e tyre.

2. Publikimi i njoftimit për zhvillimin e ankandit bëhet dy herë radhazi me një afat 5-ditor nga njëra-tjetra në Buletinin e Njoftimeve Publike, ose në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë dhe të AZHBR-së. E gjithë periudha e njoftimit zgjat 14 ditë. Në njoftim përcaktohen: data, vendi dhe ora e zhvillimit të ankandit, si dhe afati për paraqitjen e ofertave, sipas urdhrin të drejtorit të AZHBR-së. Njoftimi botohet edhe në 2 (dy) gazeta kombëtare të përzgjedhura sipas procedurave të prokurimit publik. Data e zhvillimit të ankandit do të jetë jo më parë se 20 ditë nga dita e parë e

botimit të njoftimit në Buletinin e Njoftimeve Publike ose në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë dhe të AZHBR-së.

3. Ankandi zhvillohet i hapur, çmimi i fillimit të ankandit është ai i përcaktuar nga komisioni i vlerësimit të çmimit të fillimit të shitjes me ankand dhe të miratuara nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar në njoftimin e pikës 2 më lart, dokumentacionin si më poshtë:

a) dokumentin e identitetit në rastin e një individi ose dokumentin e regjistrimit të personit fizik apo juridik (ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit);

b) kërkesën me shkrim në lidhje me objektet e ankandit, të cilat kërkon t'i blejë;

c) dokumentin e sigurimit të ofertës për ankand, i cili lëshohet nga banka dhe që konsiston në ngurtësimin për llogari të AZHBR-së të 10% të çmimit fillestar të shitjes për mallrat që kërkohen të blihen në ankand. Afati i vlefshmërisë së sigurimit të ofertës është 150 ditë nga dita e zhvillimit të ankandit. Në rast të veçantë, mund të kërkohet nga AZHBR-ja të shtyhet afati i sigurimit të ofertës së ankandit në bankë.

5. Sigurimi i ofertës së ankandit u kthehet subjekteve, kur:

a) përfundon afati i sigurimit të ofertës për ankand;

b) anulohen procedurat e ankandit;

c) nuk shpallet fitues.

6. Të gjitha subjektet, të cilët paraqesin *on-line* dokumentacionin e kërkuar për ofertën e tyre, janë të detyruara të paraqesin këtë dokumentacion edhe me zarfe, në ditën e zhvillimit të këtij procesi.

7. Kur subjekti shpallet fitues i ankandit, sigurimi i ofertës për ankand çngurtësohet vetëm në rastin kur lidhet kontrata mes palëve dhe kryhet pagesa e plotë e vlerës për të cilën është shpallur fitues.

6. HAPJA DHE VLERËSIMI I OFERTAVE

1. Komisioni i zhvillimit të ankandit i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e ankandit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit shtesë, në përputhje me procedurat e specifikuara në dokumentet e ankandit.

2. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, që kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave.

3. Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kërkuar, si dhe çmimi i çdo oferte lexohen me zë të lartë për ata persona që janë të pranishëm dhe regjistruhen në procesverbalin e procedurës së ankandit.

4. Procesverbali duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesi që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm ose i përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'i dërgohet për njoftim.

5. Komisioni i zhvillimit të ankandit, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

6. Komisioni i zhvillimit të ankandit, pavarësisht nga pika 5 më lart, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Komisioni njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.

7. Komisioni e vlerëson ofertën si të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e ankandit dhe në dokumentet e ankandit.



8. Komisioni nuk e pranon një ofertë:

a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar;

b) kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, të bërë sipas pikës 5 të këtij neni;

c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e ankandit.

9. Komisioni vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e ankandit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e ankandit.

10. Ofertat renditen duke filluar me çmimet më të larta dhe deri në ato të barabarta me çmimin fillestar minimal të shitjes. Komisioni përcakton ofertën më të mirë, pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave. Komisioni shpall fitues ofertuesin, oferta e të cilit përmbush kriteret kualifikuese dhe ka vlerën më të lartë.

7. SHPALLJA E FITUESIT

1. Komisioni i zhvillimit të ankandit, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e zhvillimit të ankandit del me një vendim me shkrim, në të cilin përcakton fituesit e ankandit, sendet e blera dhe arsyet e moskualifikimit të subjekteve të tjera.

2. Komisioni i zhvillimit të ankandit paraqet te drejtori i AZHBR-së raportin përmbledhës të zhvillimit të procedurave duke pasqyruar ankesat, emrat e subjekteve fituese dhe objektet e ankandit të blera prej tyre.

3. Pas mbarimit të afatit 5 (pesë) ditor të përcaktuar në pikën 1, njësia e ankandit boton njoftimin e fituesit sipas dokumenteve standarde të ankandit në Buletinin e Njoftimeve Publike.

4. Brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike, subjekti fitues nënshkruan kontratën e shitjes me AZHBR-në.

5. Kur ofertuesi për arsye të ndryshme nuk nënshkruan kontratën brenda këtij afati dhe nuk kryen pagesën e plotë të vlerës së objekteve të ankandit të blera, AZHBR-ja bën konfiskimin e sigurimit të ofertës për ankand. AZHBR-ja njofton ofertuesin e radhës në listën e ofertuesve të mbetur.

6. Në qoftë se pas kalimit të 10 ditëve nga shpallja e fituesve, përfituesi nuk lidh kontratën e shitjes dhe nuk kryen pagesën e plotë të vlerës për të cilën është shpallur fitues, ai e humbet të drejtën e blerjes dhe sendi i propozohet për shitje ofertuesit të dytë ose rishpallet për shitje sipas procedurave të këtij udhëzimi. Në këtë rast, sigurimi i ofertës për ankand prej 10%, që është ngurtësuar nga përfituesi i parë i ankandit është e pakthyeshme, kjo shumë kalon për llogari të AZHBR-së.

7. Kontrata e shitjes mes palëve nënshkruhet nga përfituesi dhe drejtori i AZHBR-së ose nga personi i autorizuar prej tij vetëm pasi të jetë paguar vlera e plotë e mallit ose e mallrave.

8. Tërheqja e mallrave nga pikat e magazinimit bëhet me autorizim, i cili lëshohet nga AZHBR-ja vetëm pasi të jetë lidhur kontrata e shitjes dhe të jetë likuiduar vlera e plotë e mallit.

9. Kur nga zhvillimi i 4 (katër) procedurave të ankandit për çdo mall apo grup mallrash mbeten pa u shitur, AZHBR-ja i propozon Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit uljen e çmimit fillestar të shitjes së mallrave, mbështetur në vlerësimin e Komisionit të vlerësimit të çmimit. Ulja e çmimit deri në 50% miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Në këto raste zbatohen të gjitha procedurat e ankandit.

10. Në rastet kur edhe pas zhvillimit të procedurave të ankandit mbeten pa u shitur objekte të ankandit dhe paraqiten kërkesa për blerjen e tyre apo pjesëve të veçanta, gjatë një periudhe 2-mujore, ato shiten pa ankand me komision shitjeje të ngritur nga AZHBR-ja me çmimin e ankandit të fundit.

11. Komisioni i shitjes përcaktohet me urdhër të drejtorit të AZHBR-së brenda strukturës së këtij projekti. Komisioni i shitjes pajisjet me inventarin e objekteve të ankandit, si dhe çmimet

respektive të ankandit të fundit dhe zhvillon procedurat e shitjes së tyre, sipas kërkesave të paraqitura me çmimin e ankandit të fundit të publikuar.

12. Pas kalimit të periudhës 2 (dy)-mujore, nëse ende ka objekte të ankandit të pashitura, AZHBR-ja njofton për gjendjen e tyre institucionet shtetërore që konsiderohet se kanë interes për përdorimin e tyre dhe në bazë të kërkesave dhe gjendjes fizike të objekteve kryhet transferimi pa pagesë i tyre, me miratimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të titullarit të institucionit përkatës përfitues.

13. Pas përfundimit të të gjitha këtyre procedurave të mësipërme, drejtori i AZHBR-së i propozon Ministrin të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit sistemimin e objekteve të ankandit në magazinat shtetërore ose nxjerrjen jashtë përdorimit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

8. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Përfituesit që kanë marrë objekte të ankandit dhe që kanë nënshkruar një kontratë shitjeje me këste, por që nuk shlyejnë detyrimet sipas afateve të përcaktuara në kontratën e lidhur me AZHBR-në u rimerren objektet, duke iu nënshtruar procedurave ligjore të sekuestrimit apo të dorëzimit vullnetar të tyre. Shumat e derdhura deri në atë moment nuk do t'u kthehen.

2. Objektet e sekuestruara apo të dorëzuara vullnetarisht, sipas pikës 1 të këtij kreu, bëhen hyrje në magazinën e AZHBR-së. Rishitja e tyre realizohet nëpërmjet ankandit sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore dhe të akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.

3. Udhëzimi i Ministrin të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 5, datë 13.5.2008 "Për zbatimin e kriterëve të vlerësimit dhe shitjes së traktorëve, makinerive e pajisjeve, të marra nga përdoruesit, si dhe të makinerive, pajisjeve e pjesëve të këmbimit, në gjendje në magazinën e projektit "Rritja e prodhimit ushqimor 2KR", të ardhura grant nga Japonia", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

UDHËZIM Nr. 6, datë 1.8.2012

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 89, DATË 26.1.2012 "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË PROCEDURAVE TË SHËRBIMIT TË KUJDESTARISË"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të pikës 2/V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 26.1.2012 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurave të shërbimit të kujdestarisë"

UDHËZOJ:

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në bashkëpunim me administratorët shoqërorë të njëjësive të pushtetit vendor të qarkut Tiranë: bashkinë Kamëz, komunën Paskuqan, komunën Kashar, njësitë bashkiake të Tiranës 1, 4, 5, 7, 9, 10, 11 dhe në qarkun Shkodër: bashkinë Shkodër, komunën Kastrat, komunën Rrethinat, komunën Shllak, komunën Guri i Zi do të pilotojnë zbatimin e vendimit nr. 89, datë 26.1.2012.



2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta transferon me procesverbal pranë njërive të pushtetit vendor, të përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi dosjet e fëmijëve të vendosur në shërbimin e kujdestarisë me dokumentacionet si më poshtë vijojnë:

I. Formulari nr. 1 “Mbi të dhënat e aplikuesit” dhe raporti i përgatitur nga subjekti privat që ofron shërbimin e kujdestarisë për familjen aplikuese kujdestare.

II. Formulari nr. 2 “Me të dhënat e detajuara të familjes kujdestare” dhe dokumentacionet e mëposhtme:

- a) certifikatën e gjendjes familjare dhe fotografi të prindërve;
- b) dëshmi penaliteti për anëtarët e familjes mbi 14 vjeç;
- c) raportin mjeko-ligjor që vërteton se prindërit e familjes janë të aftë fizikisht dhe mendërisht;
- d) vërtetim të lëshuar nga qendra e punës apo organet e tatim-taksave, mbi të ardhurat që kanë nga punësimi/vetëpunësimi prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes;
- e) dëftesë të shkollës për fëmijët e familjes kërkuese të cilët janë duke ndjekur shkollën/studimet;
- f) referenca për familjen nga 2 persona (njëri prej të cilëve duhet të jetë një përfaqësues i komunitetit në të cilin familja jeton).

III. Dosjen e fëmijës me dokumentacionet si më poshtë vijon:

- a) certifikatë personale e fëmijës me fotografi;
- b) 4 fotografi të fëmijës në këmbë;
- c) certifikatë familjare e fëmijës;
- d) raportin mjeko-ligjor për gjendjen shëndetësore dhe psikike të fëmijës;
- e) kopje të fletores së fëmijës për vaksinimet e kryera;
- f) dëftesën shkollë për fëmijën, nëse fëmija frekuenton një të tillë;
- g) vërtetim nga institucioni i përkujdesit shoqëror, nëse fëmija frekuenton/te një të tillë;
- h) vërtetim mbi të ardhurat financiare të prindërve biologjikë.

IV. Vendimin e gjykatës për marrjen në kujdestari nga familja aplikuese kujdestare.

V. Raportet mbi takimet fillestare të fëmijëve dhe familjes.

VI. Planin individual të ofrimit të shërbimit të kujdestarisë.

3. Administratorët shoqërorë të njërive të pushtetit vendor të sipërpërmendura verifikojnë gjendjen social-ekonomike të familjeve kujdestare ku është vendosur fëmija sipas formularit bashkëngjitur, e cila bëhet pjesë e dosjes.

4. Mbi bazën e dosjeve administratori shoqëror përgatit projektvendimin për vendosjen në shërbimin e kujdestarisë së fëmijëve dhe e paraqet në këshillin e bashkisë/komunës për ndjekjen e procedurave të mëtejshme. Projektvendimi do të përmbajë nr. rendor, emrin e kujdestarit ligjor, periudhën e përfitimit dhe masën e përfitimit.

5. Masa mujore për financimin e shërbimit të kujdestarisë sipas pikës 1 dhe 2 të kreut IV të vendimit nr. 89, datë 26.1.2012 përfitohet nga kujdestari ligjor pranë pikave të bankave ose postës ku ka vendbanimin.

6. Masa e financimit për familjen kujdestare në zbatim të pikës 3 të kreut IV të vendimit nr. 89, datë 26.1.2012 përfitohet muajin e nëntë të çdo viti kalendarik.

7. Fëmijët, të cilët vendosen në shërbimin e kujdestarisë dhe në të njëjtën kohë përfitojnë edhe statusin e jetimit, përfitojnë vetëm masën e financimit të shërbimit të kujdestarisë, sipas pikave 1-3/IV të vendimit nr. 89, datë 26.1.2012, deri në periudhën kur përfitojnë këtë shërbim.

8. Fëmijët të cilët vendosen në shërbimin e kujdestarisë dhe në të njëjtën kohë me vendim të KMCAP-it kanë nevojë për kujdestarë me pagesë, do të përfitojnë vetëm masën e financimit të shërbimit të kujdestarisë, sipas vendimit të sipërpërmendur deri në periudhën kur përfitojnë këtë shërbim dhe pagesën për individin me aftësi të kufizuar.

P.sh., fëmija që me vendim të KMCAP-it është me aftësi të kufizuar dhe ka nevojë për kujdestarë me pagesë dhe në të njëjtën kohë ky fëmijë është vendosur në shërbimin e kujdestarisë, për këtë fëmijë do të llogaritet masa e pagesës së aftësisë së kufizuar, si dhe masa e financimit të shërbimit të kujdestarisë ose e shprehur me masa përfitimi në *cash* 9300 lekë + 9000 lekë = 18.300 lekë/muaj.

9. Efektet financiare për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2012 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2012, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin “Mbrotjtja Sociale”, tit. 10 430, kap. 1, art. 606.

10. Efektet financiare do të jenë pjesë e transferimit të fondeve për periudhën shtator-dhjetor 2012.

11. Administratori shoqëror harton kërkesën për fonde për masën e financimit të shërbimit të kujdestarisë dhe e bën pjesë të kërkesës për bllok ndihmën ekonomike në muajin nëntor dhe e paraqesin në zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

12. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta merr përsipër ngritjen e kapaciteteve të administratorëve shoqërorë ku do të pilotohet ky vendim.

13. Subjektet private që ofrojnë shërbimin e kujdestarisë për fëmijët, të cilët janë në procesin e marrjes së kujdestarisë me vendim gjyqate me përfundimin e procesit, transferojnë me procesverbal, 28 dosjet pranë administratorëve shoqërorë të njëjësive të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:

- Njësia bashkiake nr. 1 Tiranë, 1 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Njësia bashkiake nr. 2 Tiranë, 1 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Njësia bashkiake nr. 3 Tiranë, 2 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Njësia bashkiake nr. 4 Tiranë, 6 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Njësia bashkiake nr. 5 Tiranë, 5 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Njësia bashkiake nr. 6 Tiranë, 2 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Njësia bashkiake nr. 7 Tiranë, 1 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Njësia bashkiake nr. 9 Tiranë, 2 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Njësia bashkiake nr. 10 Tiranë, 1 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Njësia bashkiake nr. 11 Tiranë, 2 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Komuna Kashar, 2 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Bashkia Shkodër, 10 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Komuna Shllak, 1 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Komuna Postribë, 1 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë;
- Komuna Gur i zi, 1 fëmijë në procesin e marrjes së kujdestarisë.

14. Administratorët shoqërorë me marrjen e dosjeve në dorëzim fillojnë procedurat e zbatimit të vendimit të sipërpërmendur, sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 14 ditë pas daljes në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia, Komuna _____

Datë _____

TË DHËNA MBI VIZITËN NË FAMILJE

Kryefamiljari _____ nr. dosjes _____ nr. fëmijëve
në shërbimin e kujdestarisë _____.

Koha e fillimit të trajtimit me shërbimin e kujdestarisë.

radha e vizitës _____

personi me të cilin u krye intervista _____

adresa e banimit _____

tipi i banesës: pallat shtëpi përdhese vilë barakë

me kredi pa kontratë

banesë më vete banesë e përbashkët banesë jo e tija

numri i të ndarave 1 1+1 2+1 3+1

komforti i banesës:

kuzhina _____

dhomat _____

salloni _____

banja _____

oborri _____

modifikime të banesës, përdorime për qëllime të tjera:

kryen investime në banesë: po jo

prona dhe pasuri të tjera:

gjendja shëndetësore e anëtarëve të familjes ¹ _____

²probleme sociale dhe shtëpiake të familjes _____

mendimi i administratorit shoqëror:

³krahasimi me deklaratat e kryefamiljarit:

përputhet përputhet pjesërisht nuk përputhet

Kujdestari ligjor i shërbimit të kujdestarisë

Administratori shoqëror

¹ Pyetje të drejteperdrejta a shkojnë rregullisht te mjeku i familjes? A ka familja të semure kronike? etj

² Vendosja e femijes ne kujdestari Si eshte pritur nga antaret e familjes? Si eshte perfshire familje? etj

³ Krahasimi me formularet e dorezuar Formulari 1 dhe Formulari 2 ne zbatim te VKM 89 date 26.01.2012

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 30.8.2012
Doli nga shtypi më 31.8.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 18 lekë